



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e III-të

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja e tretë, dt. 7.04.2009
Salla nr. N.10 ora 13,00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Agim Veliu, Drita Kadriu, Enis Kervan, Gani Buçinca, Adem Hajdaraj, Arsim Rexhepi, Donika Kadaj-Bujupi, Haset Cakolli dhe Mark Krasniqi.
Mungoi Memli Krasniqi.

Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu.
Për këtë mbledhje janë ftuar Ismet Beqiri, Kryetari i Komisionit për të drejta të njeriut barazi gjinore dhe peticione, dhe Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit për legjislacion dhe gjyqësi.
Në mbledhje prezantoi Ismet Beqiri, kryetari i Komisionit për të drejta të njeriut barazi gjinore dhe peticione.
Në mbledhje prezantuan përfaqësuesi i OSBE-së dhe përfaqësuesi nga presidenca dhe mediat e Kuvendit.

Mbledhjen e udhëhoqi Agim Veliu, kryetar i Komisionit.
Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara.
2. Miratimi i Rekomandimit sipas kërkesës të magjistrave të shkencës mjekësore të magjistruar në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë për vazhdimin e studimeve të Doktoraturës,
3. Shqyrtimi i kërkesës së grupit të Këshilltarëve të LDK së Kuvendit Komunal në Prizeren,
4. Të ndryshme.

Anëtarit i Komisionit Adem Hajdaraj kishte vërejtje në formulimin e pikës së dytë të rendit të ditës me çrast kërkoj që fjalët “sipas kërkesës” të zëvendësohen me :” përkitazi me kërkuesin”.

Drita Kadriu propozoi që pika e tretë e rendit të ditës që ka të bëjë me kërkesën e grupit të Këshilltarëve të LDK së Kuvendit Komunal në Prizeren, të merret si informatë e të shqyrtohet në mbledhjen e radhës pasi të përgatitet materiali.

Ky propozim nuk u miratua nga anëtarët e Komisionit

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit me vërejtjet e anëtarit Adem Hajdaraj.

1. Procesvarbali i mbledhjes së kaluar u miratua me vërejtjen e deputetit Gani Buçinca lidhur me riformulimin e diskutimit të tij.

Kryetari i Komisionit fillimisht i dëshiroi mirëseardhje anëtarit të ri të Komisionit Arsim Rexhepi.

Lidhur me pikën nën të ndryshme kryetari i informoi anëtarët e Komisionit lidhur me përfundimin e Kryesisë së Kuvendit që Komisioni të përmbushë obligimin ligjor të Organeve dhe Këshillave të themeluara nga Kuvendi.

Obligohet stafi i Komisionit që të përgatisë Raport lidhur me Organet, Agjencitë dhe Këshillat e formuara nga Kuvendi që janë në kompetencë të Komisionit.

2. **Miratimi i Rekomandimit përkitazi me kërkesat e magjistrave të shkencës mjekësore të magjistruar në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë për vazhdimin e studimeve të Doktoraturës.**

Kryetari Veliu lidhur me këtë pikë fjalën ia dha Ismet Beqirit, Kryetari i Komisionit për të drejta të njeriut barazi gjinore dhe peticione.

Ismet Beqiri në diskutimin e tij tha se Komisioni për të drejta të njeriut barazi gjinore dhe peticione ka shqyrtuar dhe debatuar lidhur me kërkesën e magjistrave të shkencës mjekësore të magjistruar në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë për vazhdimin e studimeve të Doktoraturës, dhe në bazë të kësaj ka miratuar Rekomandim me të cilin ka kërkuar që të bëhet vlerësimi i ligjshmërisë së konkurseve të vitit 2005 dhe 2009 duke respektuar Ligjin për arsimin e lartë dhe Statutin e Universitetit të Prishtinës.

Gjithashtu ky Komision ka kërkuar që të bëhet edhe verifikimi i listave të kandidatëve të pranuar në konkurs si dhe të formohet një grup i përbashkët i Senatit dhe UP-së i cili do të merret me këtë çështje.

Ndërsa, Mimistrisë së Arsimit, Komisioni për të drejta të njeriut i ka sugjeru që të bëjë rishikimin e Ligjit për Arsimin e Lartë dhe ta shpejtojë procesin e ndryshimit të tij., përfundoi diskutimin e tij kryetari i Komisionit për të drejta të njeriut Ismet Beqiri.

Adem Hajdaraj mendon se nuk janë bërë analizat e duhura me rastin e doktoraturave, dhe se është e pa arsyeshme që 120 magjistra të vazhdojnë doktoraturën përnjëherë. Sipas tij duhet shiqohet edhe forma ligjore e doktoraturës dhe atë që e parasheh Statuti i Universitetit.

Ne si Komision duhet të kërkohet rishikimin e Ligjit të arsimit të Lartë dhe të presim rekomandimin e grupit punues të Senatit dhe Fakultetit të Mjekësisë. Më tej shtoi se përkrah Rekomandimin e Komisionit për Legjislacion dhe gjyqësi lidhur me këtë çështje.

Drita Kadriu konsideron se shkeljet në shkollim kanë ndodhur në disa forma. Lidhur me këtë ka marrë si shmbull dosjen e kompletuar të kandidatit Fisnik Kurshumliu, për të cilin thuhet se i plotëson të gjitha kriteret por i njëjti nuk është pranuar për shkak të një gabimi teknik.

Përkundër instistimit dhe kërkës së këtij kandidati që të shqyrtohet dokumentacioni i tij dhe dy mbledhjeve të Senatit nuk është bërë korigjimi i gabimit teknik që është bërë ndaj tij. Si çështje tjetër e rëndësishme është edhe kompenzimi për doktratura jashtë vendit. Ajo mendon se sikur të analizohen dosjet e të gjithë ankuesve do të shihej edhe shkelja e kriterëve të konkursit me këtë rast propozon që tu ipet mundësia e konkurimit të gjithë të intersuarve.

Lidhur me këtë propozon që:

- të rishikohet vendimi i Senatit të UP-së i datës 6.10.2005 për ndërprerjen e studimeve të doktoraturës të magjistrave të shkecape mjekësore
- të rishikohet konkursi i UP-së i datës 19.1.2009 për studime të doktoraturës dhe të shiqohen shkeljet procedurale.

Mark Krasniqi mendon se çështja e doktoraturës është çështje individuale e jo kolektive.

Ne si Komision duhet të shqyrtojmë gjërat në mënyrë që të mos pengohet askush dhe të punojmë vetëm në bazë të Ligjit .

Donika Kadaj-Bujupi

Përkrah rekomandimin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi lidhur me këtë çështje, dhe mendon se hulumtimet e rastit mund t'i shërbejnë Komisionit si ndihmë në rekomandimet shtesë lidhur me shkeljet eventuale të ligjit.

Komisioni duhet të miratojë rekomandim lidhur me këtë çështje dhe të kërkojë nga Ministria raport për rezultatet e arritura nga rekomandim e Komisionit.

Heset Cakolli

Konsideron se duhet gjetur zgjedhje të problematikës së krijuar gjithnjë në kuadër të Ligjit të Arsimit të Lartë dhe Statutit të UP-së. Sipas Statutit të UP-së është nxjerrë edhe Rregullorja për studimet e doktoraturës, në kuadër të kësaj duhet të shikohet dhe të përshejtohet ndryshimi i Ligjit për Arsimin e Lartë.

Arsim Rexhepi përkrah rekomandimet Komisionit për Legjislacion dhe mendon se problemet e krujuara në Universitet janë çështje që duhet zgjidhur me këtë rast vlerëson se vet ekzistenca e 30 000 studentëve në Universitetin e Prishtinës krijon probleme e që duhet të bëhet zgjidhje me ndarjen në dy apo tri njësi apo Universitete.

Gani Buqinca propozon:

- që të rishikohet dhe përshejtohet ndryshimi i Ligjit për Arsimin e Lartë
- që Inspekcioni i Arsimit të rishikojë a janë shkelur kriteret e konkursit
- ti rekomandohet Senatit dhe Dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë të formojë një Komision të përbashkët që do të verifikojë zbatimin e ligjit
- të shqyrtohet arsyshmëria e kërkesave, numri dhe mundësia e doktoraturës.

Kryetari i Komisionit **Agim Veliu** konstatoi se pas debatit të anëtarëve të Komisionit lidhur me magjistrat e Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë për vazhdimin e studimeve të Doktoraturës, dhe miratohet ky:

R e k o m a n d i m

1. E drejta për shkollim në të gjitha nivelet është e drejtë Kushtetuese e secilit qytetarë të Republikës së Kosovës.
 2. Çështja e titujve dhe gradave është tërësisht çështje akademike e cila është e paraparë në Statutin e UP-së, sipas një forme e cila është e përcaktuar nga MASHT-i .
 3. MASHT, ta verifikojë procesin e konkursit të shpallur nga UP dhe ta informojë Komisionin Parlamentar për gjetjen eventuale.
 4. Komisioni konstatoi se nuk ka shkelje të Ligjit për Arsim të lartë në Kosovë dhe të Statutit të UP-së.
 5. Komisioni kërkon nga MASHT që në afatin e paraparë të procedohen ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për Arsimin e Lartë.
- 3. Shqyrtimi i kërkesës së grupit të Këshilltarëve të LDK së Kuvendit Komunal në Prizeren**

Kryetari tha se kërkesa e grupit të Këshilltarëve të LDK së Kuvendit Komunal në Prizeren ka të bëjë me konkursin për vendet e punës drejtor dhe zëvendës drejtor në shkollat fillore dhe të mesme të Komunës së Prizrenit. Ky konkurs paraqet një shkelje të ligjit për Arsimin Lokal dhe të Udhëzimit Administrativ 03/2009 të datës 23.03.2009. Sipas këtij Ligji dhe Udhëzimit Administrativ vendet e punës për të cilat është shpallur konkursi janë valide gjer në vitin 2010 dhe 2011, ndërsa konkursi duhet të shpallet tre muaj para skadimit të mandatit për këto vende.

Donika Kadaj tha se lidhur me këto dhe shkeljet tjera që aktualisht po ndodhin në këtë Komunë ka informuar Komisionin në mbledhjet e më parme.

Ne si Komision jemi të obliguar ta monitorojme Ligjin si po zbatohet nëpër komuna dhe me këtë rast kërkon që Komisioni të vizitojë Komunën e Prizrenit në mënyrë që të hartojë një rekomandim lidhur me implementimin e ligjeve të arsimit nëpër komuna.

Gani Buqinca vlerëson se duhet shqyrtuar dhe analizuar kërkesat e tilla dhe të merren masa adekuate ndaj atyre që kanë shkelur ligjin. Duhet të kërkojmë informatë nga Ministria e arsimit dhe Inspekcioni i arsimit që të verifikojë ligjshmërinë e konkursit me rastin e shpalljes së konkursit për këto vende pune nga komuna e Prizrenit.

Arsim Rexhepi mendon se emrimi i drejtorëve në baza partiake është evident dhe këtë çështje duhet ndaluar. Ai tha se ne si Komision duhet të kërkojmë informatë nga Ministria lidhur me zbatimin e ligjit dhe të bëhet një vizitë në Komunën e Prizrenit në mënyrë që për së afërmi të merren informata lidhur me këtë çështje.

Heset Cakolli the se nëse i referohemi Udhëzimit Administrativ 03/2009 shihet se afati për konkurs është tre muaj para skadimit të mandatit në këtë rast shihet se është shkelur ligji dhe duhet të kërkojmë sqarim nga Ministria lidhur me këtë.

Enis Kervan mendon se Komisioni nuk mund të kërkojë anulimin e konkurrit, ngase këtë duhet ta bëjë Ministria. Ai mendon se Komisioni duhet të vizitojë komunën e Prizrenit dhe më këtë rast të takohet me zyrarët e Komunës dhe me drejtorët e shkollave të kësaj Komune.

Drita Kadriu tha se nuk e vlerëson dhe nuk e përkrah mënyrën e shkruar të këtij dokumenti nga ana e këshilltarëve. Komuna duhet paraprakisht të shqyrtojë kontratat e punës si dhe bazën e shpalljes së konkursit. Ajo mbështet propozimin që Inspekcioni i arsimit ta japë mendimit e vet lidhur me gjendjen e krijuar në këtë komunë .

Mark Krasniqi konsideron se me këtë rast është shkelur ligji dhe se duhet të merren masa ndaj atyre që e kanë shkelur ligjin.

Adem Hajdaraj vlerëson se nuk i përkrah disa nga akuzat e Këshilltarëve komunalë të Prizrenit por pajtohet me atë që duhet respektuar afatin e vlefshmërisë së kontratave.

Kryetari propozoi që pas debatit të anëtarëve të Komisionit, lidhur me kërkesën e Grupit të Këshilltarëve të LDK-së, si dhe të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme të Komunës së Prizrenit të nxirret ky:

R e k o m a n d i m

- 1. Komisioni konstatoi se konkursi i shpallur nga DKA në Prizren për vendet e punës drejtor dhe zëvendës drejtor në shkollat fillore dhe të mesme të Komunës së Prizrenit është në kundërshtim me Ligjin për Arsimin Lokal.**
- 2. Komisioni kërkon nga kryetari i Kuvendit Komunal të Prizrenit anulimin e konkursit për Drejtorë dhe Zëvendës drejtorë të shkollave fillore dhe të mesme të datës 19 dhe 23.3.2009.**

3. Komisioni kërkon nga MASHT-i informatë për mosrrespektimin e Ligjit dhe të Udhëzimit Administrativ 03/2009 të datës 23.03.2009.

Për këtë rekomandim votuan 6 anëtarë të Komisionit, kundër ishte Drita Kadriu dhe Enis Kervan abstenoj.

Lidhur me këtë çështje anëtarët e Komisionit në përbërje Enis Kervan, Donika Kadaj Gani Buçinca dhe Arsim Rexhepi më datë 14.4.2009 do të vizitojnë komunën e Prizrenit me çrast do të njihen për së afërmi me zbatimin e Ligjit për Arsimin Lokal.

4. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit i informoi anëtarët tjerë lidhur me përfundimin e Kryesisë së Kuvendit që Komisioni të përmbushë obligimin ligjor të Organeve dhe Këshillave të themeluara nga Kuvendi.

Komisioni duhet të rishikojë funksionimin e Këshillave të formuara nga Kuvendi që janë në kompetencë të Komisionit dhe të përgatisë raport me Rekomandime lidhur me obligimet që dalin nga këto organe.

Gani Buçinca lidhur me këtë kërkoi që të shiqohen ligjet dhe obligimet që dalin nga këto ligje si dhe mënyra buxhetore e tyre.

Lidhur me këtë kërkon të sqarohet edhe çështja e raportimit të Institutit Albanologjik Institutit të Historisë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës që janë themeluar nga Kuvendi i Kosovës.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 15, 40

Kryetari i Komisionit,
Agim Veliu